



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:140889  
Datë: 23.01.2024  
Numri i dokumentit: 05230021

Ac.nr.2739/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj - kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses K. , rr. “M”, nr....., ..., Pejë, e përfaqësuar nga A.K, zyrtare ligjore pranë paditëses, kundër të paditurës F.H.B nga Istogu i Poshtëm, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditëses të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.261/19, i datës 18.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses K. , rr. “M”, nr....., ..., Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.261/19, i datës 18.02.2021 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.261/19, të datës 18.02.2021 ka vendosur si në vijim:

*“I.REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Distrikti në Peje, rr. “M”, nr....., K-Peje, me të cilën ka kërkuar që të: DETYROHET e paditura F.H.B nga Istogu i Poshtëm që t’ia kompensojë dëmin paditëses në shumën prej 394.69 Euro, si pasojë e kryerjes së veprës penale, me kamatë ligjore prej 8% nga dita, e ushtrimit të kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, si dhe ti paguaj shpenzimet procedurale, në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.*”

*II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale. ”*

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ka paraqitur i autorizuari i paditëses për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar apo aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datë 01.07.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumë prej 364.69 euro, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.261/19, të datës 18.02.2021, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pasi ka bërë vlerësimin e provave dhe pretendimet e palës së paditur ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar konform nenit 357 pika 1 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Peje – Dega Istog, P.nr.324/14 i datës 10.02.2016, i formës së prerë me datë 02.03.2016, është vërtetuar se e paditura është shpallur fajtores për veprën penale ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 321 par.1 të KPRK-së, me ç’ rast i ka shkaktuar dëm material paditëses në shumën prej 394.69 Euro, gjë e cila vërtetohet edhe nga fatura me nr. DPE14HP06258 e datës 13.10.2014 ku në emër të rikthimit të humbjeve figuron shuma prej 394.69 Euro.

Me tutje, ka shtuar se, në kuptim të nenit 357 par.1 të LMD-së, është e parashkruar dhe si e tillë duhet refuzuar, ngase ky nen përcakton në mënyrë decisive së kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Peje – Dega Istog, P.nr. 324/14 i datës 10.02.2016, i cili është bërë i formës së prerë me datë 02.03.2016, ndërsa paditësja padinë e ka parashtruar në gjykatë me datë 01.07.2019, që do të thotë së padia është parashtruar pas afatit ligjor prej tre (3) vitesh, që i bie të ketë kaluar 3 (tre) vite e 3 (tre) muaj e 30 ditë, për çka Gjykata nxjerr përfundim se padia e paditëses është e parashkruar dhe si e tillë duhet refuzuar.

Vendimi lidhur me shpenzimet procedurale gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore,

Mbi bazën e të lartcekur , e në kuptim te dispozitave ligjor nga 357 pika 1 të LMD/, e lidhur me nenin 8 , nenit 143, nenit 450 të LPK , u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse, se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë, kjo për faktin se, se nuk ka qenë kontestuese se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Peje – Dega Istog, P.nr.324/14 i datës 10.02.2016, i formës së prerë me datë 02.03.2016, e paditura është shpallur fajtores për veprën penale ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 321 par.1 të KPRK-së, me ç’ rast i ka shkaktuar dëm material paditëses në shumën prej 394.69 Euro, gjë e cila vërtetohet edhe nga fatura me nr. DPE14HP06258 e datës 13.10.2014 ku në emër të rikthimit të humbjeve figuron shuma prej 394.69 Euro, i cili është bërë i formës së prerë me datë 02.03.2016, ndërsa padinë paditësja e ka parashtruar në gjykatë me datë 01.07.2019, që do të thotë së padia është parashtruar pas afatit ligjor prej tre ( 3) vitesh.

Por, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kërkesëpadia e paditëses është parashtruar për shkak të kalimit të afatit 3 vjeçar, brenda të cilit paditësja ka pasur të drejtë konform dispozitave të LMD-së që të kërkojë kompensimin e dëmit. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale.

Neni 357 i LMD paragrafi 1 dhe 2 përcaktojnë se: *“1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. Është fakt se deri në momentin e paraqitjes së padisë nuk kanë kaluar me tepër se 3 vite që do të thot se paditësja padinë e ka paraqitur pasi kanë kaluar 3 (tre) vite e 3 (tre) muaj e 30 ditë, nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.*

Meqenëse paditësja padinë e ka paraqitur me 01.07.2019, edhe Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta për të kërkuar kompensimin e dëmit është parashtruar për shkak të kalimit të afatit 3 vjeçar, pra kanë kaluar më shumë se 3 vite.

Gjykata ankimore vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjta i gjeti pa ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Numri i lëndës: 2019:140889  
Datë: 23.01.2024  
Numri i dokumentit: 05230021

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2739/2021, me datë 16.01.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.